



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 11, datë 14.01.2021

PËR
CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË
VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË
FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 90/3, 94/1 e 97/3 të Kodit të Procedurës Administrative, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

VENDOSI:

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR MAT

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, Ardit Kuka, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, çështjen civile me palë paditëse: {...}; I paditur: {...}. Tiranë; Objekti: “Pavlefshmëri titulli”.
2. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, Edvan Veçani, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; I pandehur: {...}; Objekti: “Kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq”.
3. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, Xhevdet Lika, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Neni 130/a/3 i Kodit Penal”.
4. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, Ardit Kuka, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Neni 284/1 i Kodit Penal”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KURBIN

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krupë, Arnisa Këlliçi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Objekti: “Sigurim prove”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KUKËS

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Sami Ujkashi si dhe gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, Flutura Hoxha, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, çështjen penale me: Kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kukës; I pandehur: {...}; Akuza: “Neni 278/a/1 i Kodit Penal”.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, Amarilda Sulaj (relatore), si dhe gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Enkeleda Dalipi e Aulon Pashaj, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, çështjen penale me kërkues: Kërkues: {...}; Të pandehur{...} etj.; Akuza: “Nenet 283/2, 278/2, 278/3, 287, 248 të Kodit Penal”.

3. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Sami Ujkashi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Fshehje e te ardhurave, parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal”.

4. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, Amarilda Sulaj si dhe gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Enkeleda Dalipi, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR PUKË

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Tonin Sterkaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, çështjen gjyqësore me kërkues: Kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pukë; I pandehur: {...}; Objekti: “Dhunë në familje”.

2. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, Florin Demollari (relator), Alma Ahmeti si dhe gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Besmir Stroka, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, çështjen gjyqësore Kërkues{...}; I pandehur: {...}; Akuza: “Vjedhje me dhunë”, kryer në bashkëpunim, parashikuar sipas nenit 139-25, 278 të Kodit Penal.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR PËRMET

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, Blerta Marku (Çibuku), caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, çështjen me objekt: “Kërkesë për gjykim ndaj të pandehurit {...}i akuzuar për kryerjen e veprës penale “Dhuna në familje”, parashikuar nga neni 130/a/1 i Kodit Penal”.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, Suela Dashi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, çështjen me objekt: “Kërkesë për dërgim në gjyq ndaj të pandehurve {...}, etj”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR SARANDË

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, Marjola Beluli, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, çështjen civile me palë paditëse: {...}; e paditur: {...}; Objekti: “Shpërblim dëmi moral, biologjik dhe psikologjik i shkaktuar nga fakti i paligjshëm”

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR POGRADEC

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Sonjela Voskopi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, çështjen gjyqësore me kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pogradec; I pandehur: {...}; Akuza: “Vrasje me dashje” e kryer ne bashkëpunim, e mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 76, 22 e 25 të Kodit Penal”

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, Elisabeta Gjoni, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, çështjen civile me palë paditëse {...}; I paditur: {...}, Ministria e Drejtësisë, {...} (ish gjyqtare/kryetare e gjykatës), Z{...}”; Objekti: “Detyrimin e të paditurve në mënyrë solidare për shpërblimin jopasuror të shkaktuar nga veprimet e parregullta të personit juridik Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe të punonjësve të saj, etj.”

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR BERAT

1. Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të Kërkesës nr.1728 prot., datë 07.12.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore në ngarkim të të pandehurit {...}; i akuzuar për kryerjen e veprës penale “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur”, e mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 100/1 e 22 të Kodit Penal”.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË GJIROKASTËR

1. Gjyqtari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, Ligoraq Toshi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, çështjen civile me palë paditëse {...}; Të paditur: {...}; Objekti: “Shpalljen e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 6, datë 06.11.1992, nr. 126 prot., për zgjidhjen e kontratës në emër të {...}”
2. **GJYKATA E APELIT SHKODËR**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Durrës, Izet Dushaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Objekti: “Përrjashtim gjyqtari”.

GJYKATA E POSAÇME E APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Durrës, Anita Mici, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar,

çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Falsifikim dokumentesh, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal”.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR